



# **TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE**

**Tremujori II 2024**

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore**

## **Përmbajtje**

I . HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME.....	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE .....	5
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare.....	5
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare.....	8
3. Treguesit e e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare.....	9
4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë .....	11
5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë.....	11

## I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e dytë të vitit 2024, si edhe krahasimet me periudhat pararendëse. Ky raport publikohet në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al), në seksionin “Statistika rreth AKEP”/“Shërbimet Postare”.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

## II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e dytë të vitit 2024 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP për periudhën e raportimit janë:

1. Air Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.);
2. Albanian Delivery Express sh.p.k;
3. ALOPOST sh.p.k;
4. BIPEX sh.p.k;
5. Blendi Dokollari –Person Fizik (Flash Delivery Albania);
6. DHL International (Albania) sh.p.k;
7. Elite Post sh.p.k;
8. EXPRESS ALB 24 sh.p.k;
9. Fation Qama – Person fizik (Express City);
10. GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.);
11. GENIKI TAXYDROMIKI ALB sh.p.k;
12. Greenposta sh.p.k;
13. INTEX COURIER sh.p.k.;
14. IPOST sh.p.k;
15. Milsped Albania sh.p.k;
16. Mr. COURIER sh.p.k;
17. POSTA JONË sh.p.k;
18. POSTMAN sh.p.k;
19. T.N.T Express Albania sh.p.k;

20. Top Post sh.p.k;
21. Ultra C.E.P. sh.p.k;
22. Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex);
23. United Transport sh.p.k. (Uni Trans);
24. Youth Albania Professional Services (YAPS).

Posta Shqiptare me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

Gjatë periudhës nga tremujori i parë i vitit 2024 deri në tremujorin e dytë të vitit 2024, nuk ka pasur subjekte të çregjistruar për ofrimin e shërbimeve postare dhe kanë raportuar të dhënat statistikore 24 subjekte<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Ofrues të shërbimeve postare që kanë raportuar të dhënat statistikore në AKEP deri më datë 20.07.2024

### III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara nga ofruesit e shërbimeve postare administrohen dhe përpunohen në përputhje me përcaktimet e rregullores së AKEP Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare” dhe përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres.

#### 1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 rezultojnë 6,667,394 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të cilat në mënyrë më të detajuar paraqiten në tabelën si më poshtë vijon.

**Tabela 1.1:** Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara 2023 - 2024

Shërbime postare të ofruara	T1_2023	T2_2023	T3_2023	T4_2023	T1_2024	T2_2024	Ndryshim T2_2024/ T1_2024	Ndryshim T2_2024/ T2_2023
<b>Posta Shqiptare sh.a</b>								
<b>1 Shërbim Universal Postar</b>								
1.1 Postë brenda vendit	5,351,099	3,679,866	4,098,479	4,522,704	4,727,732	4,942,119	5%	34%
1.2 Postë ndërkombëtare	184,390	188,482	186,888	183,248	158,687	369,800	133%	96%
<b>1.3 Totali 1.1+1.2</b>	<b>5,535,489</b>	<b>3,868,348</b>	<b>4,285,367</b>	<b>4,705,952</b>	<b>4,886,419</b>	<b>5,311,919</b>	<b>9%</b>	<b>37%</b>
<b>2 Shërbim jouniversal postar</b>								
2.1 Postë brenda vendit	92,252	164,019	72,173	73,570	86,517	57,479	-34%	-65%
2.2 Postë ndërkombëtare	146	631	532	574	233	55	-76%	-91%
<b>2.3 Totali 2.1+2.2</b>	<b>92,398</b>	<b>164,650</b>	<b>72,705</b>	<b>74,144</b>	<b>86,750</b>	<b>57,534</b>	<b>-34%</b>	<b>-65%</b>
<b>3 Shërbim ekspres</b>								
3.1 Ekspres brenda vendit	126,129	126,802	129,033	109,818	117,001	113,575	-3%	-10%
3.2 Ekspres ndërkombëtar	3,883	3,954	1,329	3,234	3,005	3,667	22%	-7%
<b>3.3 Totali 3.1+3.2</b>	<b>130,012</b>	<b>130,756</b>	<b>130,362</b>	<b>113,052</b>	<b>120,006</b>	<b>117,242</b>	<b>-2%</b>	<b>-10%</b>
<b>Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare</b>								
<b>4 Shërbim JoUniversal Postar</b>								
4.1 Postë brenda vendit	196,289	199,271	153,457	154,541	90,551	190,982	111%	-4%
4.2 Postë ndërkombëtare	2,819	4,295	4,304	23,192	1,764	1,956	11%	-54%
<b>4.3 Totali 4.1+4.2</b>	<b>199,108</b>	<b>203,566</b>	<b>157,761</b>	<b>177,733</b>	<b>92,315</b>	<b>192,938</b>	<b>109%</b>	<b>-5%</b>
<b>5 Shërbim ekspres</b>								
5.1 Ekspres brenda vendit	712,332	679,269	689,710	825,031	825,844	833,005	0.9%	23%
5.2 Ekspres ndërkombëtar	63,387	104,757	119,519	123,551	136,049	154,756	14%	48%
<b>5.3 Totali 5.1+5.2</b>	<b>775,719</b>	<b>784,026</b>	<b>809,229</b>	<b>948,582</b>	<b>961,893</b>	<b>987,761</b>	<b>3%</b>	<b>26%</b>
<b>6 Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3</b>	<b>6,732,726</b>	<b>5,151,346</b>	<b>5,455,424</b>	<b>6,019,463</b>	<b>6,147,383</b>	<b>6,667,394</b>	<b>8%</b>	<b>29%</b>

Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën sa më sipër, në vijim janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur disa nga zhvillimet kryesore përgjatë kësaj periudhe.

### **Posta Shqiptare (Ofrues i Shërbimit Universal)**

- ✓ **Shërbim universal postar.** Ky zë në total ka pasur rritje në masën 37% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës dhe rreth 9% krahasuar me 3 mujorin e pararendës. Edhe zëri '*Postë brenda vendit*' ka pasur rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, ashtu dhe me pararendës, respektivisht në masën 34% dhe në masën 5%. Gjithashtu, edhe zëri '*Postë Ndërkombëtare*' ka shënuar rritje të konsiderueshme në masën 96% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe një rritje të konsiderueshme në masën 133% krahasuar me 3-mujorin e parë të vitit 2024.
- ✓ **Shërbimi Jo universal postar.** Ky zë në total ka pësuar një rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në nivelin 65% dhe në nivelin 34% krahasuar tremujorin e parë 2024. Në të njëjtat nivele paraqitet edhe zëri '*Postë brenda vendit*'. Edhe në zërin '*Postë ndërkombëtare*' për pjesën jashtë shërbimit universal ka një rënie me 91% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe me 76% krahasuar me 3-mujorin e parë 2024.
- ✓ **Shërbimi Ekspres.** Ky zë në total ka pësuar rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 10% dhe me 2% në krahasim me 3-mujorin e parë 2024. Edhe shërbimi '*Ekspres brenda vendit*' ka pasur rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 10% dhe në masën 3% në krahasim me 3 mujorin e parë 2024, ndërsa zëri '*Ekspres Ndërkombëtar*' ka pësuar rënie krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 7%, dhe rritje në masën 22% krahasuar me 3-mujorin e parë 2024.

### **Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare**


- ✓ **Shërbimi Jo Universal Postar.** Ky zë ka një rritje në 3-mujorin e II 2024 në krahasim me 3-mujorin e parë të vitit 2024 në masën 109%, ndërsa në krahasim me 3-mujorin e II të vitit të kaluar ka pësuar një rënie në masën 5%. Edhe zëri '*Postë brenda vendit*' ka pasur rritje në krahasim me 3-mujorin e parë të vitit 2024 në masën 111%, dhe rënie në masën 4% krahasuar me 3-mujorin II të vitit të kaluar. Po ashtu, zëri '*Postë ndërkombëtare*' ka pasur një rritje në krahasim me 3-mujorin e parë 2024 në masën 11%, dhe rënie në masën 54% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit pararendës.
- ✓ **Shërbimi ekspres.** Ky zë ka pasur rritje në totalin e tij krahasuar me 3-mujorin e kaluar T1 2024 në masën 3%, dhe në masen 26% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Edhe zëri i shërbimit '*Ekspres brenda vendit*' ka pasur një rritje shumë të vogël në masën 0.9% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm dhe në masën 23% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. E njëjta ecuri evidentohet edhe për zërin e shërbimit '*Ekspres ndërkombëtar*', i cili ka pasur rritje krahasuar si me 3-mujorin e parë 2024 ashtu edhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë, përkatësisht në masat 14% dhe 48%.

**Tabela 1.2:** Totali i objekteve postare Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T2 2024

	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	5,486,695	82%
<i>Of. e tjerë</i>	1,180,699	18%
<b>Totali</b>	<b>6,667,394</b>	<b>100%</b>

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafiku 1.1:** Totali i shërbimeve postare, krahasimi në periudha tremujore



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, shikojmë një rritje në objektet postare në T2 – 2024 krahasuar me T1 – 2024 si për Postën Shqiptare ashtu dhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë kemi një rritje të totalit të objekteve postare për Postën Shqiptare dhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.


**Tabela 1.3:** Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T2-2024

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
5,311,919	250,472	1,105,003	6,667,394
80%	4%	17%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e raportuara nga Posta Shqiptare rezulton se volumin më të madh të objekteve postare për këtë operator e zë shërbimi universal postar me rreth 80% të totalit të objekteve, ndjekur nga shërbimi ekspres me rreth 17% dhe shërbimi jo universal me rreth 4 %.

**Grafiku 1.2:** Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar. Nga krahasimi i periudhës T2 – 2024 krahasuar me T1 – 2024 vërehet që kemi një rritje në masën 8% në volumin total të shërbimeve postare. Gjithashtu, rritje në masën 30% evidentohet edhe krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.

## 2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

**Tabela 1.4:** Shërbimi Universal Postar T2 – 2024


Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	4,942,119
Postë ndërkombëtare	369,800
<b>Totali</b>	<b>5,311,919</b>

Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga të dhënat e tabelës 1.4 për T2 – 2024, për sa i përket shërbimit Universal Postar, vihet re se Posta Shqiptare realizoi gjithsej 5,311,919 objekte, nga të cilat posta brenda vendit zë 93% të objekteve postare dhe posta ndërkombëtare zë 7% të objekteve postare. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 4,211,041 shërbime për objekte të thjeshta dhe 731,078 shërbime për objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 176,212 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 193,588 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.



**Grafiku 1.3:** Shërbimi universal postar sipas tremujorëve



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga grafiku i mësipërm, vërehet një rritje e shërbimit universal postar në T2 – 2024 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2024, në masën rreth 9%.

### 3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare

Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

**Tabela 1.5:** Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare sipas zërave përkatës (P. Sh)


Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut T-2 2024	Pjesa tregut T-2 2023
Shërbim universal postar	5,311,919	96.8%	92.9%
Shërbim jo universal postar	57,534	1.0%	4.0%
Shërbim ekspres	117,242	2.1%	3.1%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 96.8%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 2.1% dhe nga shërbimi jo universal postar 1.0%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një rënie të Shërbimit jo universal postar dhe të Shërbimit ekspres.

**Grafiku 1.4:** Ecuria e volumeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare

### P.SH - Ecuria në 3 mujor për llojet e shërbimeve postare



	T1_2023	T2_2023	T3_2023	T4_2023	T1_2024	T2_2024
Shërbim universal postar	5,396,459	3,868,348	4,285,367	4,705,952	4,886,419	5,311,919
Shërbim jo universal postar	118,564	164,650	72,705	74,144	86,750	57,534
Shërbim ekspres	142,904	130,756	130,362	113,052	120,006	117,242
<b>Totali</b>	<b>5,657,927</b>	<b>4,163,754</b>	<b>4,488,434</b>	<b>4,893,148</b>	<b>5,093,175</b>	<b>5,486,695</b>

Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare, ku vihet re një rritje e shërbimit universal, dhe një rënie e atij jo universal dhe shërbimit ekspres në T2-2024 krahasuar me T1-2024.

#### 4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

**Tabela 1.6:** Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T2-2024	Pjesë tregu T2-2023
P.Sh	57,534	23%	45%
Of. e tjerë	192,938	77%	55%
<b>Totali</b>	<b>250,472</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafiku 1.5:** Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në T2-2024 krahasuar me T1-2024 kanë pësuar rritje në total në masën 40%, por ky tregues në mënyrë të ndarë ka shënuar rënie prej 34% për Postën Shqiptare dhe rritje me rreth 109% për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë T2 – 2024 përbëhet nga 248,461 objekte brenda vendit dhe 2,011 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

## 5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të dytë të vitit 2024, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2023, mbi baza tremujore.

**Tabela 1.7:** Volumet e ofrimit të shërbimit ekspres për periudhën T2 – 2024

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T2-2024	Pjesë tregu T2-2023
P. Shqiptare	117,242	11%	14%
Of. e tjerë	987,761	89%	86%
<b>Totali</b>	<b>1,105,003</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafik 1.6:** Volumet e ofrimit të shërbimit ekspres për periudhën 2023 – 2024



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Shërbimi ekspres, gjatë tremujorit T2 – 2024 ka shënuar rritje në krahasim me T1 – 2024 në masën 2% dhe është rritur me rreth 25% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë së bashku është në vlerën 946,580 objekte postare ose 86% e totalit të këtij shërbimi, ndërsa shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 158,423 objekte postare ose 14% e totalit të këtij shërbimi për periudhën raportuese.

Për sa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri është në vlerën 128,496 objekte dhe sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit është në vlerën 29,927 objekte.